



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

D R E J T O R I A P Ë R B U J Q Ë S I D H E P Y L L T A R I

Ne mbështetje të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr,2003/3,ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr ,2004/29 për Pyjet e Kosovës,Udhëzimit Administrativ nr .06/2010 lidhur me shitjen e trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore, plani i prerjes për vitin 2013, Ref\APK 123/2013, datë 03.04.2013, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Gjiçan, shpallë:

A n k a n d i n nr. 01/2013

Me të cilin ftohen të gjithë operatorët ekonomik të licensuar, që janë të interesuar për blerjen e masës drusore në pyll (në këmbë) që të dorëzojnë ofertat e tyre për sasinë dhe asortimentin e evidentuar në tabelat e poshtëshënuara.

Shitja e Masës Drusore në Këmbë në ngastren nr.29 në Zhegoc

| Asortimenti | Lloji i drurit | Vëllimi m³ | Qmimi fillestar € | Totali në € |
|--------------------|-----------------------|------------------------------|------------------------------|--------------------|
| Dru teknik | Ahu | 79,39 | 28,01 | 2.223,71 |
| Dru zjarri | Ahu | 489 | 14,73 | 7.202,97 |
| Dru teknik | Shkozë | 0 | 0 | 0,00 |
| Dru zjarri | Shkozë | 35,82 | 14,73 | 527,63 |
| Dru teknik | Plep | 2,3 | 28,01 | 64,42 |
| Dru zjarri | Plep | 2,73 | 12,23 | 33,39 |
| Dru teknik | Bung | 2 | 28,29 | 56,58 |
| Dru zjarri | Bung | 9,26 | 14,96 | 138,53 |
| Total | | 620,5 | | 10.247,23 |

| Asortimenti | Lloji i drurit | Vëllimi m³ | Qmimi fillestar € | Totali në € |
|--------------------|-----------------------|------------------------------|--------------------------|--------------------|
| Dru teknik | Bung | 41,2 | 27,99 | 1.153,19 |
| Dru zjarri | Bung | 551,53 | 14,36 | 7.919,97 |
| Dru teknik | Shkozë | 41,55 | 14,47 | 601,23 |
| Total | | 634,28 | | 9.674,39 |

Të gjitha ndërmarrjet të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet nga kontratat e më hershme me APK-në ose qe kane fleteparaqitje per kundervajtje apo veper penale lidhur me demet ne pyje, nuk kanë të drejtë konkurimi.

Kriteret për të konkuruar në tender/ankand janë:

- Certifikatën e Regjistrimit te Biznesit.
- Dëshminë për përgatitjen profesionale dhe teknike- licencën për kryerjen e aktiviteteve përkatëse sipas U.A nr;03/2008 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurat për dhënien e licencave për kryerjen e punëve në pyje dhe toka pyjore të dt;06.03.2008.
- Certifikatën mbi kryerjen e obligimeve tatimore nga Administrata Tatimore e Kosoves jo më të vjetër se tre muaj, nga dita e aplikimit.
- Dëshmi të lëshuar nga Autoriteti Pyjor Komunal në Gjilan, dhe Agjencioni Pyjor i Kosovës, Drejtoria Kordinuese Gjilan se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pa kryera nga kontrata të mëhershme.
- Dëftesa për pagesën e shumës prej 20,00 €uro për pjesmarrje në ankand/tender.

Kriteret vijuese që do të kërkohen për vlerësimin e tenderit janë:

- Çmimi më i lartë i ofruar vendos 70% fituesin e tenderit.
- Referencë-dëshmi mbi kryerjen me sukses të punëve të realizuara nga kontratat e më hershme i hartuar sipas procesverbalit të komisionit për pranim dorëzimin e ngastrave pyjore sipas nenit 45 paragrafi 2 të U.A nr;29/2005, vendos 20% fituesin e tenderit;
- Dinamika më e shkurtër e propozuar në ofertë për kryerjen e punëve vendos 10% fituesin e tenderit;

Në aplikacion të shenohen edhe:

- Emrin e Njësisë Menaxhuese, numrin e ngastrës dhe sasinë për të cilën paraqitet oferta.
- Çmimin e ofruar për m³ të asortimenteve drunore veç e veç për dru zjarri dhe lëndë teknike, per secilin lloj te drurit.
- Afati kohor – dinamika e realizimit të punëve për ngastrën përkatëse.

Subjektet e licencuara që dëshirojnë të marrin pjesë në Ankand Publik, pesë (5) ditë para mbylljes mund të bëjnë vizita në terren në përcjellje të zyrtarëve të Autoritetit Pyjor Komunal.

Informatat detale për vizitat për çdo ngastër pyjore mund te merren në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave do të jetë më datën 25.04.2013 deri në ora 14:00

Ofertat duhet të dorzohen në zyrën e Drejtorise Komunale për Bujqesi dhe Pylltari ne Gjilan, dhe duhet të jenë kopja dhe origjinali të mbyllura.

Hapja e ofertave do të bëhet nga komisioni i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në prezence të ofertuesve më datën 25.04.2013 në ora 14:30.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky tender përcaktohen me Kontratë mes Drejtorise per Bujqesi dhe Pylltari në Gjilan dhe fituesit të tenderit.

Gjilan, 07.04.2013

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari
Ing. i dipl. Nazmi Rapuca